
COMPARATIVE ANALYSIS OF THE POLITICAL SYSTEM OF NORTH MACEDONIA AND KOSOVO

Lindita Neziri

Mother Teresa University, Republic of North Macedonia, lindita.neziri@unt.edu.mk
lindita_neziri@outlook.com

Argëtim Saliu

Mother Teresa University, Republic of North Macedonia, argtim.saliu@unt.edu.mk

Abstract: North Macedonia and Kosovo were part of the former Yugoslavia. The political system of North Macedonia (hereinafter RNM) and Kosovo, have evolved from similar historical and geopolitical contexts. Both countries share a complex history of ethnic diversity and a transition from post-socialist governance to democratic governance.

RNM and Kosovo built political systems that reflect their historical backgrounds, ethnic diversity and aspirations for integration into the European Union.

RNM and Kosovo, two neighbouring countries, are facing different challenges in building democratic institutions, good governance, the rule of law, reforming state administration and other efforts toward European integration.

According to the constitutional provision, RNM and Kosovo are independent and democratic states, which means that governance is based on the principles of democracy, political pluralism and ethnic representation.

RMV and Kosovo are Parliamentary Republics. From a theoretical – normative aspects, both states respects the principles implied by this form of state organization, starting from: separation of state powers into executive, legislative and judicial; independence of state powers; interaction between executive and legislative power, etc.

Although the RNM and Kosovo have the same type of political system, there are evident differences in the structure of governance, including the method of electing the President of the Country, the representation of non – majority communities within central-level state institutions, the structure of the Government, the structure of the Parliament, the method of electing deputies, etc.

This paper has theoretical approach. This study aims to analyse the political systems of NRM and Kosovo.

The study highlights similarities and differences in the governance structure of two neighbouring countries with similar political system.

For the needs of this research, we use: historical methods, descriptive- comparative methods, analysis of constitutional and legal provisions and scientific doctrines.

The study offers suggestions for improving the democracy and better governance.

Keywords: North Macedonia, Kosovo, President, Parliament, Government

ANALIZË KRAHASUESE E SISTEMIT POLITIK TË MAQEDONISË SË VERIUT DHE KOSOVËS

Lindita Neziri

Universiteti “Nënë Tereza”, Republika e Maqedonisë së Veriut, Lindita.neziri@unt.edu.mk;
lindita_neziri@outlook.com

Argëtim Saliu

Universiteti “Nënë Tereza”, Republika e Maqedonisë së Veriut, argtim.saliu@unt.edu.mk

Abstrakt: Maqedonia e Veriut dhe Kosova ishin pjesë e Republikës Federale të Ish Jugosllavisë. Sistemi politik i Maqedonisë së Veriut (më tutje RMV) dhe Kosovës ka evoluar nga një kontekst i ngjashëm historik dhe gjeopolitik. Të dy shtetet ndajnë histori komplekse të diversitetit etnik si edhe të tranzicionit nga qeverisja post-socialiste në qeverisje demokratike.

RMV dhe Kosova ndërtuan sistem politik që pasqyrojnë historikun, përbërjen etnike dhe aspiratat e tyre për integrim në Bashkimin Evropian.

RMV dhe Kosova, dy shtete fqinje po kalojnë sfida të ndryshme në ndërtimin e institucioneve demokratike, qeverisjes së mire, sundimit të ligjit, reformimit të administratës shtetërore dhe përpjekjeve tjera për integrim në Bashkimin Evropian.

Bazuar në dispozitat kushtetuese, RMV dhe Kosova janë shtete të pavarura, shtete demokratike që do të thotë se qeverisja bazohet në respektimin e parimeve të demokracisë, pluralizmin politik dhe përfaqësimin etnik.

RMV dhe Kosova janë Republika Parlamentare, d.m.th në aspektin teorik-normativ të dy shtetet respektojnë parimet që i nënkupton kjo formë e organizimit të pushtetit shtetëror, duke filluar nga: ndarja e pushtetit në ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësorë; pavarësia e pushteteve; bashkëpunimi mes pushtetit ligjvënës dhe ekzekutivit, etj.

Edhe pse RMV dhe Kosova kanë sistem të njëjtë politik, janë të dukshme dallimet dhe ndryshimet në strukturën e qeverisjes përfshirë mënyrën e zgjedhjes së Presidentit të vendit, përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në institucionet shtetërore të nivelit qendror, përbërja e Qeverisë, përbërja e Kuvendit, mënyra e zgjedhjes së deputetëve, etj.

Punimi ka qasje teorike, Qëllimi i punimit është të analizohet sistemi politik i RMV-së dhe Kosovës.

Punimi nxjerr në pah ngjashmëritë dhe dallimet në strukturën e qeverisjes të dy shteteve fqinje me sistem politik të njëjtë.

Për nevojat e punimit përdoren metoda historike, metoda deskriptive – krahasuese, analizë e dispozitave kushtetuese dhe ligjore dhe doktrina shkencore.

Punimi ofron rekomandime për avancim të demokracisë dhe qeverisje më të mirë.

Fjalë kyçe : Maqedonia e Veriut, Kosova , Presidenti, Kuvendi, Qeveria

1. HYRJE

RMV dhe Kosova, dy shtete fqinje kanë sistem të njëjtë të qeverisjes (sistem politik parlamentar). Bazuar në dispozitat kushtetuese, Kosova dhe RMV janë Republika demokratike parlamentare.

Republika parlamentare është formë e rregullimit shtetëror që karakterizohet me ndarje të pushtetit shtetëror, me pavarësinë e pushteteve, bashkëpunim dhe ndërveprim mes legjislativit dhe ekzekutivit. Në shtetet me sistem politik parlamentar: Kuvendi është qendra kryesore e marrjes së vendimeve me karakter politik; Kuvendi zgjedh institucionet e nivelit më të lartë shtetërore Presidentin, Qeverinë, Avokatin e popullit, Prokurorin Publik, etj. Me vet faktin që i zgjedh kjo i jep të drejtë edhe të mbykqyr dhe të kontrolloj punën e tyre.

Punimi ndahet në tri pjesë. Në pjesën e parë dhe të dytë, veçmas trajtohet sistemi politik në RMV dhe Kosovë, në pjesën e tretë bëhet analizë krahasuese në strukturën e qeverisjes së dy shteteve të lartëpërmendura, me çrast dalin në pah ngjashmëritë dhe dallimet në qeverisjen e tyre.

Hipoteza e hulumtimit: *‘RMV dhe Kosova, dy shtete me përbërje shumëetnike, qeverisen në mënyrë demokratike’.*

Pyetja e hulumtimit: *Cilat janë dallimet dhe ngjashmëritë në qeverisjen e RMV-së dhe Kosovës?*

2. MATERIALE DHE METODOLOGJIA

Për nevojat e punimit përdoret metoda deskriptive - krahasuese, analiza ligjore, doktrina shkencore përfshirë literaturë akademike të autorëve të ndryshëm vendas dhe të huaj, hulumtime shkencore të botuara në revista ndërkombëtare si dhe web faqet zyrtare. Për nevojat e hulumtimit kryesisht analizojmë dispozitat kushtetuese, (Kushtetuta e RMV-së dhe Kosovës) dhe ligjet pozitive që rregullojnë organizimin e institucioneve kushtetuese të të dy shteteve veçmas (RMV dhe Kosovë) si: Kodi zgjedhor, Ligji për Qeverinë, Ligji për Presidentin, Rregullorja e punës së Kuvendit, etj.

3. SISTEMI POLITIK I RMV-SË

Kuvendi

Korniza ligjore që rregullon funksionimin dhe organizimin e Kuvendit, përfshin: Kushtetutën, Rregulloren e punës së Kuvendit, Ligjin për deputet. Më tej, korniza ligjore përfshin edhe ligjet përmes të cilave rregullohet procedura dhe kushtet për zgjedhjen e deputetëve si: Kodi Zgjedhor, Kodi Penal, Ligji për partitë politike, udhëzimet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve etj (Neziri, 2024: 160).

Sipas Kushtetutës, Kuvendin e përbëjnë 120-140 deputetë (neni 62). Sipas Kodit zgjedhor, në Kuvend zgjidhen 123 deputetë, 120 sipas modelit proporcional, me ç’rast territori i RMV-së ndahet në 6 njësi zgjedhore dhe në secilën zgjidhen nga 20 deputetë. Tre deputetë zgjidhen sipas modelit të shumicës edhe atë nga një deputet nga tre njësitë zgjedhore: në Amerikën Jugore dhe Veriore, në Afrikë dhe Evropë dhe në Azi dhe Australi (neni 4)

Kandidat për deputet, mund të jetë secili shtetas i RMV-së, nëse: ka mbushur 18 vjet, është i aftë për punë nuk është i dënuar me vendim gjyqësor për vuajtje të dënimit me burg mbi gjashtë muaj (neni 7). Deputetët zgjidhen për një mandat prej 4 vitesh. Nga radha e deputetëve me shumicë absolute zgjidhet Kryetari i Kuvendit dhe një ose më shumë nënkryetarë (Ligji për Kuvendin, neni 17).

Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve, që do të thotë se deputetët përfaqësojnë interesat e qytetarëve (Ligji për Kuvendin, neni 2). Kuvendi është bartës i pushtetit ligjvënës, d.m.th funksioni primar i tij është miratim i Kushtetutës dhe amendamenteve kushtetuese; miratim i ligjeve dhe amendamenteve ligjore; miratim i planit

hapësinor; miratim i buxhetit shtetëror; ratifikim i marëveshjeve ndërkombëtare. Kuvendi është vendi ku merren vendime të rëndësishme politike, vendime që janë në interes të përgjithshëm. Kuvendi merr vendim për ndryshimin të kufijve të Republikës; për aderim apo dalje nga aleanca apo bashkësia me shtete tjera; vendos për luftë dhe paqe; shpall referendum. Kuvendi konsiderohet edhe si organ zgjedhor dhe kontrollues nga vet fakti që Kuvendi është organi që zgjedh Qeverinë, gjykatësitë në Gjykatën Kushtetuese, Avokatin e Popullit, Prokurorin Publik etj, përderisa i zgjedh edhe kontrollon aktivitetet e tyre përmes mjeteve/ instrumenteve që i ka në dispozicion (si pyetja e deputetëve, interpelanca, mocioni i mosbesimit, komisionet anketuese etj) (Kushtetuta, neni 68).

Presidenti

Korniza ligjore me të cilën rregullohen kushtet dhe kompetencat e Presidentit përfshin: Kushtetutën, Ligjin për President dhe Kodin Zgjedhor. Presidenti është shef i shtetit, përfaqëson Republikën dhe është komandant suprem i forcave të armatosura të RMV-së Presidenti është bartës i pushtetit ekzekutiv por me një rol ceremonial dhe është nën “hijën” e Qeverisë (Neziri, 2021: 253).

Sipas Kushtetutës, kandidat për President mund të jetë çdo individ që ka shtetësinë e RMV-së, ka banuar në RMV së paku 10 vjet në 15 vitet e fundit, ka arritur moshën 40 vjet, ka zotësi veprimi, nuk është zgjedhur paraprakisht dy herë në funksionin President, e propozojnë së paku 30 deputetë ose 10 000 zgjedhës të regjistruar në Listën zgjedhore. Bazuar në dispozitat kushtetuese, Presidenti zgjidhet sipas sistemit zgjedhor të shumicës (mazhoritar) dy raundesh, me një mandat prej 5 vitesh me të drejtën të rizgjidhet vetëm njëherë (nenet 80-81). Zgjedhjet presidenciale organizohen në gjithë territorin e RMV-së dhe në përfaqësi diplomatike – konsullore të RMV-së në: Afrikë dhe Evropë, në Amerikën Veriore dhe Jugore dhe në Azi e Australi (Kodi zgjedhor, neni 4). Në raundin e parë, Presidenti i Republikës zgjidhet kandidati që siguron shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Listën e zgjedhësve. Nëse asnjë kandidat nuk siguron shumicën e nevojshme, atëherë brenda 14 ditëve nga përfundimi i votimit të parë organizohet raundi i dytë i zgjedhjeve. Në raundin e dytë votohet vetëm për dy kandidatët që në raundin e parë kanë pasur më shumë vota dhe zgjidhet kandidati që siguron shumicën e votave nga zgjedhësit që kanë votuar. Nëse edhe në raundin e dytë nuk zgjidhet asnjë nga kandidatët e propozuar, përsëritet e gjithë procedura (Kushtetuta, neni 81).

Presidenti fiton legjitimitet nga vota e qytetarëve, megjithatë roli i tij dallon nga vendet me sistem presidencial apo gjysmëpresidencial ku zgjedhja e Presidentit bëhet drejtpërsëdrejti nga qytetarët (Neziri, 2022: 255).

Sipas Kushtetutës, ‘*Presidenti cakton mandatarin për formimin e Qeverisë; emëron dhe revokon ambasadorë dhe përfaqësues të RMV-së jashtë vendit; pranon letra kredenciale e revokuese të përfaqësuesve të huaj diplomatikë; propozon dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor; propozon dy gjykatës të Gjykatës Kushtetuese; propozon anëtarët e Këshillit për Marrëdhënie Ndëretnike; emëron tre anëtarë të Këshillit për Siguri, emëron dhe shkarkon edhe bartës të tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj; ndan mirënjohje dhe dekorata; bën faljen sipas ligjit sidhe detyra tjera të caktuara me Kushtetutë*’ (Kushtetuta, neni 84). Presidenti përgjigjet për shkelje të dispozitave kushtetuese dhe dispozitave ligjore. Iniciativën për verifikimin e përgjegjësisë e ndërmerr Kuvendi me 2/3 e votave nga numri i gjithë deputetëve, kurse vendimin e merr Gjykata Kushtetuese me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i gjykatësve. Nëse Gjykata Kushtetuese vërtetohet shkelje kushtetuese apo ligjore, atëherë Presidenti shkarkohet (Kushtetuta, neni 87).

Qeveria

Bartës kryesor i pushtetit ekzekutiv është Qeveria. Korniza ligjore me të cilën rregullohet formimi dhe kompetencat e Qeverisë përfshin: Kushtetutën, Ligjin për Kuvend dhe Rregulloren e Kuvendit. Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Të njëjtit nuk mund të jenë deputetë në Kuvend dhe as të ushtrojnë funksione tjera publike (Kushtetuta, neni 89).

Presidenti i shtetit, në afat prej 10 ditëve nga dita e konstituimit të Kuvendit, mandatin për formimin e Qeverisë ia beson kandidatit të partisë apo të koalicionit partiak që ka fituar në zgjedhjet parlamentare. Nga dita kur i besohet mandati, mandatarin ka afat 20 ditë që të paraqet programin dhe të propozoj përbërjen e Qeverisë para Kuvendit. Për formimin e Qeverisë votojnë deputetët në Kuvend. Qeveria konsiderohet e zgjedhur atëher kur mandatarin siguron shumicën e votave nga përbërja e përgjithshme parlamentare, d.m.th 61 vota nga 120 deputetë (Rregullorja e Kuvendit, nenet 109- 113). Qeveritë e RMV-së zakonisht janë qeveri të koalicionit. Qeveria ka mandat 4 vjeçar. Mandati ndërpritet nëse: votohet mocion i mosbesimit ndaj Qeverisë, Qeveria jep dorëheqje, Kuvendi shpërndahet. Vdekja e Kryeministrit, dorëheqja e tij dhe pamundësia e përhershme për të ushtruar funksionin, konsiderohet si dorëheqje e Qeverisë (Kushtetuta, nenet 92-93).

Anëtarët e Qeverisë kanë përgjegjësi individuale për çështje nga fushëveprimi i tyre. Anëtarët e Qeverisë përgjigjen para Kuvendit. Kuvendi nëpërmjet instrumenteve parlamentare si pyetje e deputetëve, interpelanca, mocioni i mosbesimit, komisionet hetuese, etj, kontrollon veprimtarinë dhe aktivitetet e tyre (Neziri, 2025: 73).

Qeveria është organ ekzekutiv, d.m.th propozon politika shtetërore, ligje, planin hapësinor, buxhetin shtetëror. Qeveria kujdeset dhe mban përgjegjësi për zbatimin e politikave shtetërore dhe ligjeve në praktikë. Qeveria cakton

parimet e organizimit të punës së ministrive dhe organeve tjera të administratës, sidhe mbikëqyr punën e tyre. “*Qeveria merr vendim për njohjen e shteteve; vendos marrëdhënie konsullore dhe diplomatike me shtete tjera; propozon Prokuror Publike, propozon dhe emëron ambasadorë, përfaqësues të RMV-së jashtë vendit dhe shefa të përfaqësive konsullore; propozon Prokurorin Publik; emëron dhe shkarkon bartës të funksioneve publike dhe funksioneve tjera të caktuara me dispozita kushtetuese dhe ligjore, kryen edhe punë tjera të caktuara me Kushtetutë dhe me ligj*” (Kushtetuta, neni 91).

Gjykatat

Gjyqësia është unike. Kompetencat, përbërja dhe organizimi i Gjykatave rregullohet me ligj. Karakteristikë e gjyqësorisë është pavarësia e Gjykatave, ligjshmëria, gjykim i paanshëm dhe objektiv, mbrojtja, respektimi i drejtave dhe lirive të qytetarit, barazia, mosdiskriminimi, sundim i ligjit. Gjykatat gjykojnë në bazë të dispozitave kushtetuese, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare (Kushtetuta, neni 98).

Gjykatësit kanë mandat të pakufizuar. Sistemin gjyqësor e përbëjnë: Gjykata Themelore, Gjykata Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Gjykata Supreme është gjykata më e lartë në Republikë. Në RMV funksionon edhe Gjykata Administrative dhe Gjykata Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese mbron kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, përbëhet prej 9 gjykatësve, i zgjedh Kuvendi me mandat 9 vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje (Kushtetuta, nenet 98, 109).

4. SISTEMI POLITIK I KOSOVËS

Kuvendi

Organizimi dhe funksionimi i Kuvendit rregullohet me Kushtetutë dhe me Rregullore. Bazuar në dispozitat kushtetuese, Kuvendi numëron 120 deputetë. 20 nga 120 ulëse, garantohen për përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, edhe atë: 10 vende garantohen për përfaqësuesit e komunitetit Serb dhe 10 vende për përfaqësuesit e komuniteteve tjera: 3 ulëse për përfaqësuesit e komunitetit Boshnjak, 2 për komunitetin Turk, 1 përfaqësues nga komuniteti Rom, 1 nga komuniteti Ashkali, 1 nga komuniteti Egjiptian, 1 për përfaqësues të komunitetit Goran edhe 1 vend shtesë i jepet përfaqësuesit nga komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme (neni 64). Kuvendin e përfaqëson Kryetari i Kuvendit, atë e propozon grupi më i madh parlamentar dhe zgjidhet pasi të votohet nga shumica e gjithë deputetëve. Kuvendi numëron 5 nënkryetarë, 3 nënkryetarë propozohen nga tri grupet më të mëdha parlamentare. Dy nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, njëri nënkryetar duhet të jetë nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve nga komunitetet tjera joshumicë (rom, ashkali, egjiptian, boshnjak, turk ose goran). Deputeti i zgjedhur nuk mund të ushtrojë asnjë post ekzekutiv ose qeveritar (neni 73).

Kuvendi miraton: Kushtetutën /amendamentet kushtetuese; ligje/amendamente ligjore, akte të përgjithshme si: rregullorja Kuvendit, rezoluta, vendime, rekomandime, deklarata (Rregullorja, neni 3) Kuvendi shpall referendum, ratifikon traktatet ndërkombëtare, miraton Buxhetin e shtetit. Kuvendi zgjedh Presidentin dhe ka të drejtë të inicioj procedurë për shkarkim të tij/saj nga detyra. Kuvendi zgjedh dhe mbykqyr Qeverinë, zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial (Kushtetuta, neni 65).

Kuvendi ka mandat katërvjeçar, megjithatë mandati mund të vazhdohet në raste të gjendjes së jashtëzakonshme për aq sa zgjat ajo gjendje. Kuvendi shpërndahet nëse nuk mund të formohet Qeveria brenda 60 ditëve nga dita e caktimit të mandatarit; nëse nuk mund të zgjidhet Presidenti i shtetit brenda 60 ditëve nga dita kur fillon procedura e zgjedhjes së tij/sa; nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë 2/3 e gjithë deputetëve; nëse votohet mosbesim i Qeverisë (Kushtetuta, neni 82).

Presidenti

Kushtet, mënyra e zgjedhjes dhe kompetencat e Presidentit rregullohen me Kushtetutë, Ligjin për President dhe Rregulloren e Kuvendit. Kandidat për President mund të jetë çdo shtetas i Kosovës me vendbanim të përhershëm në Kosovë për së paku 10 vitet e fundit, ka mbushur 35 vjet, arrinë të siguroj nënshkrimet e të paktën 30 deputetëve të Kuvendit (Ligji për President, neni 3). Presidenti zgjidhet në Kuvend me votim të fshehtë. Në garën presidenciale kandidojnë minimumi dy kandidatë dhe maksimumi 4. Seanca për zgjedhjen e Presidentit është e veçantë, solemne, unike. Përfshin tri raunde të votimit. Në votimin e parë dhe të dytë Presidenti zgjidhet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën 2/3 në dy votimet e para, atëherë organizohet votimi i tretë. Në votimin e tretë votohet për dy kandidatët që kanë numrin më të lartë të votave, zgjidhet kandidati që siguron shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Nëse edhe në votimin e tretë, asnjë kandidat nuk siguron numrin e duhur të votave, atëher Kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhje të reja (Kushtetuta, neni 86). Për të qenë i vlefshëm votimi i parë dhe votimi i dytë, duhet të marrin pjesë në votim të paktën 80 deputetë, ndërsa në votimin e tretë duhet të marrin pjesë të paktën 61 deputetë (Rregullorja e Kuvendit, neni 106).

Presidenti ka mandat 5 vjet me të drejtën e rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat. Presidenti duhet të heq dorë nga të gjitha funksionet publike dhe partiake (Ligji për President, nenet 5-7).

Presidenti i Republikës mund të shkarkohet nëse dënohet për kryerjen e ndonjë krimi të rëndë, shkelje të Kushtetutës dhe paaftësisë për të ushtruar përgjegjësitë për shkaqe shëndetësore.

Sipas dispozitave kushtetuese, *“Presidenti përfaqëson shtetin; garanton funksionimin demokratik të institucioneve kushtetuese, është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës, udhëheq politikën e jashtme, shpall zgjedhjet parlamentare; nxjerr dekrete; shpall ligje, ka të drejtën e vetos suspensive (e drejta e kthimit të ligjeve për rishqyrtim nëse mendon se janë të dëmshme për interesat e shtetit apo komuniteteve të saj), nënshkruan marrëveshje ndërkombëtare; udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete; cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, emëron dhe shkarkon funksionarë shtetëror, jep medalje, çmime, shpall falje individuale, etj”* (neni 84).

Qeveria

Organizimi dhe funksionimi i Qeverisë rregullohet me Kushtetutë dhe me Ligjin për Qeveri.

Përbërja e Qeverisë bazohet në përfaqësimin e barabartë gjinor si dhe në përfaqësimin e komuniteteve (Ligji për Qeveri, neni 4). Ministrinë themelohen sipas nevojës. Nëse themelohen 12 ministri, 1 ministër duhet me patjetër të jetë nga komuniteti serb dhe 1 Ministër nga ndonjëra prej komuniteteve tjera joshumicë (boshnjak, turk, rom, goran, ashkali), të paktën 2 zëvendësministra nga komuniteti serb dhe 2 zëvendësministra nga komunitetet tjera joshumicë. Nëse themelohen më shumë se 12 ministri, Qeveria duhet të ketë edhe një ministër të tretë - përfaqësues i ndonjëris prej komuniteteve joshumicë, një zëvendësministër të tretë - përfaqësues të komunitetit Serb dhe 1 zëvendësministër përfaqësues i komuniteteve tjera joshumicë (Kushtetuta, neni 96).

Pas zgjedhjeve parlamentare, Presidenti cakton kandidatin për Kryeministër në konsultim me partinë ose koalicionin partiak që ka fituar zgjedhjet. Kandidati për Kryeministër, brenda 15 ditëve pas emërimit, paraqet programin dhe përbërjen e Qeverisë para Kuvendit. Qeveria zgjidhet nëse siguron shumicën e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit (Kushtetuta, neni 95). Mandati i Qeverisë është 4 vjet. Mandati përfundon edhe më herët nëse votohet mocioni i mosbesimit për Qeverinë në tërësi, Kryeministri jep dorëheqje dhe me shpërndarjen e Kuvendit (Ligji për Qeverinë, neni 28).

“Qeveria propozon projekte, amendamente kushtetuese dhe projektligje, propozon dhe zbaton politika të jashtme, emëron dhe shkarkon brenda kompetencave ligjore; miraton dokumente dhe plane për zbatim të ligjeve dhe politikave qeveritare; miraton raport vjetor dhe raporte periodike për zbatimin e politikave shtetërore, ligjeve dhe akteve nënligjore; etj” (Ligji për Qeveri, neni 8).

5. ANALIZË KRAHASUESE E SISTEMIT POLITIK NË RMV DHE KOSOVË

RMV dhe Kosova, janë Republika demokratike Parlamentare, janë shoqëri shumëetnike ku respektohen parimet e demokracisë (sundimi i ligjit, pluralizmi politik, etj).

RMV dhe Kosova kanë sistem të njëjtë të qeverisjes (sistem politik parlamentar), që do të thotë se në përgjithësi ka ngjashmëri në mënyrën e qeverisjes, funksionimin dhe organizimin e pushtetit shtetëror.

Pavarësisht sistemit të njëjtë të qeverisjes, në RMV dhe Kosovë zgjedhja e Presidentit të shtetit realizohet në mënyra të ndryshme. Në RMV, Presidenti zgjidhet nga qytetarët, kurse në Kosovë e zgjedh Kuvendi. Kushtet që duhet ti plotësoj kandidati i propozuar për President janë të ngjashme por ka dallim tek mosha. Në Kosovë, kandidati për President duhet të ketë mbushur 35 vjet, kurse në RMV, 40 vjet. Në RMV, kandidati për President ka dy alternative – mund të siguroj 10.000 nënshkrime nga qytetarët ose 30 nënshkrime nga deputetët, kurse në Kosovë duhet 30 nënshkrime nga deputetët. Dallime vërrehen edhe tek kompetencat, sidomos tek udhëheqja e politikës së jashtme.

Sa i takon mënyrës së formimit (zgjedhjes) të Qeverisë, procedura është e ngjashme, d.m.th Qeverinë e formon lideri i partis/koalicionit që ka fituar zgjedhjet parlamentare dhe merr votat e duhura nga Kuvendi (61 nga 120 deputetë). Dallime ka në afatet që parashihen për caktimin e mandatarit nga ana e Presidentit si dhe afatet e parashikuara për formimin e Qeverisë. Tek të dyja shtetet, me Qeverinë udhëheq kryeministri. Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, zvkryeministrat dhe ministrat, numri i ministrive nuk është fix por themelohen varësisht nga nevoja. Dallimi vërrehet tek garanca kushtetuese për përfaqësim të komuniteteve joshumicë në përbërjen e Qeverisë. Në Kosovë, komunitetet joshumicë kanë garancë kushtetuese për përfaqësim në ministri. Nëse ka 12 ministri, me patjetër 1 ministër duhet të jetë nga komuniteti serb dhe 1 ministër nga ndonjëra prej komuniteteve tjera joshumicë; nëse janë më shumë se 12 ministri atëherë garantohet edhe 1 ministri për komunitetet joshumicë, kurse, në anën tjetër, përfqësimi i komuniteteve joshumicë në RMV varret nga koalicioni qeveritar dhe marrëveshja që arrihet mes tyre.

Kuvendi është organi që miraton Kushtetutën, ligjet, buxhetin shtetëror, zgjedh Qeverinë, etj. Shikuar përgjithësisht, kompetencat që ka Kuvendit tek të dy shtetet veçmas, janë të ngjashme, dallimi qëndron në faktin se në Kosovë Kuvendi zgjedh Presidentin e Republikës. Dallim ka edhe tek përbërja e Kuvendit. Kështu, me dispozitat kushtetuese maqedonase, Kuvendi numëron 120-140 deputet, numri i ulëseve për komunitetet joshumicë varret nga rezultati që arrihet në zgjedhjet parlamentare, kurse në Kosovë, Kuvendi numëron numër fix- 120 deputet, me atë që 20 prej 120 ulëseve garantohen për komunitetet joshumicë (10 për përfaqësuesit nga komuniteti serb dhe 10 për përfaqësuesit nga komunitetet tjera joshumicë).

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

RMV dhe Kosova, dy shtete fqinje, me një të kaluar të përbashkët (në kuadër të ish Jugosllavisë), qeverisen në mënyrë demokratike, d.m.th në aspektin formal garantohet krijimi dhe funksionimi i institucioneve demokratike, sundimi i ligjit, zgjedhja e përfaqësuesve nëpërmjet zgjedhjeve, etj.

RMV dhe Kosova kanë ngjashmëri në strukturën e qeverisjes si Republika parlamentare; në përgjithësi, ka dallime tek detajet teknike (si afatet e ndryshme), por më se të dukshme janë dallimet në mënyrën e zgjedhjes së Presidentit dhe garantimi kushtetues - përfaqësim etnik në përbërjen e Qeverisë dhe Kuvendit në Kosovë .

RMV dhe Kosova, kanë prioritet strategjik integrimin në Bashkimin Evropian dhe të dy shtetet përballen me sfida deri diku të ngjashme në këtë rrugëtim.

Thelbësore për avancim të qeverisjes demokratike mbetet lufta kundër korrupsionit dhe zbatim efektiv i ligjeve edhe në aspektin praktik.

LITERATURA

Azizi, A. & Neziri, L. (2023). Evaluation of public administration reforms in North Macedonia from the perspective of European Commission's annual progress reports, HKJU-CCPA, vol.23. (1), p. 35–60 e qasshme në

Link: <https://www.ccpa-journal.eu/index.php/ccpa/issue/current>

Azizi, A. & Neziri, L. (2022). Rule of law in the Republic of Macedonia over the last decade evaluated by international authorities. Balkan Social Science Review Vol 20. p. 7-27. E qasshmen në

Link: <https://js.ugd.edu.mk/index.php/BSSR/article/view/5497>

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut me amendamentet e Kushtetutës I-XXX, e disponueshme online në: <http://www.sobranie.mk>

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e qasshme në <http://www.sobranie.mk>

Kodi zgjedhor teksti i konsoliduar (version jo zyrtar i përgatitur nga shërbimi profesional i komisionit shtetëror të zgjedhjeve) (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11 – tekst i pastruar dhe 142/12) e qasshme në: <https://www.sobranie.mk/rregullorja-e-kuvendit-te-republikes-se-maqedonise-gazeta-zyrtare-e-republikes-se-maqedonise-numer-91-2008.nsp>

Ligji nr. 03/I-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti IV / nr. 47 / 25 janar 2009 e qasshme në : <https://gzk.rks-gov.ne>

Ligji nr.08/I-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovë e qasshme në <https://gzk.rks-gov.ne>

Neziri, L. (2025). The role and importance of control over Public Administration in North Macedonia. Knowledge-international Journal , 68(1),71–75 <https://ojs.ikm.mk/index.php/kij/article/view/7107>

Neziri, L.(2024). The role and place of the Parliament in the political system of the Republic of North Macedonia: Relations between the legislative power and the executive power. Knowledge - international Journal , 62(1), 159–162. E qasshme në <https://ojs.ikm.mk/index.php/kij/article/view/6574>

Neziri, L.(2024). The state as a specific organisation of society: State organisation of North Macedonia. Knowledge - international Journal , 62(1), 147–151. E qasshme në <https://ojs.ikm.mk/index.php/kij/article/view/6572>

Neziri, L.(2024). Public Administration and the state. Knowledge - international Journal , 63(1), 99–102. E qasshme në <https://ojs.ikm.mk/index.php/kij/article/view/6670>

Neziri, L.(2022). Analysis of the electoral system for presidential elections in the Republic of North Macedonia: advantages and disadvantages. Knowledge - International Journal , 51(1), 251–256. E qasshme në <https://ojs.ikm.mk/index.php/kij/article/view/5061>

Neziri, L. (2022) The necessity to Change the Macedonian Electoral System for Parliamentary Elections, in “International Dialogue: East-West” Vol. 9, pp. 17-21; e qasshme në: https://konferencii.msu.edu.mk/wp-content/uploads/000-Pravo-i-Politikologija-2022_book-FINAL.pdf

Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë e disponueshme online në <https://www.sobranie.mk>

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/>